

PROGRAM KUNDËR KORRUPSIONIT I AGJENCISË SË ZBULIMIT

Hyrje

Agjencia e Zbulimit (Agjencia) është organ i posaçëm i administratës shtetërore, përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizimin, vlerësimin, shkëmbimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave dhe informacioneve relevante për sigurinë, mbrojtjen, interesat e politikës së jashtme dhe interesat ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. .

Agjencia është pjesë e bashkësisë së sigurisë-zbulimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, merr pjesë në sistemin e sigurisë kolektive të Aleancës Veriatlantike dhe merr pjesë aktive në organet e NATO-s, përgjegjëse për zbulimin civil.

Kompetencat e Agjencisë realizohen duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për Agjencinë e Zbulimit, Ligjin për informacione të klasifikuara, Ligjin për qasje të lirë në informata dhe rregullore të tjera ligjore. Në këtë drejtim, një nga obligimet e Agjencisë është mbrojtja e informacioneve të klasifikuara, ndërsa informacionet që janë të karakterit publik, i ka publikuar në mënyrë transparente në ueb faqen <https://www.ia.gov.mk>.

Kontroll dhe mbikëqyrje mbi punën e Agjencisë, në përputhje me rregulloret ligjore, kryen Komisioni Parlamentar për mbikëqyrje mbi punën e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe Agjencisë së Zbulimit. Gjegjësisht, në përputhje me ligjin për Agjencinë e Zbulimit, drejtori i Agjencisë është i obliguar që Komisionit (në përputhje me kompetencat e tij) t'i mundësojë inspektim në punën e Agjencisë dhe të japë njoftime dhe të dhëna për punën e Agjencisë për çështjet e lidhura me:

- respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligje;
- ligjshmërinë në zbatimin e kompetencave të Agjencisë në aspektin e tejkalimit të kompetencave, ndërmarrjes së procedurave të paautorizuara, keqpërdorimeve dhe parregullsive të tjera në funksionim, në kundërshtim me të drejtat e përcaktuara me ligj;
- metodat dhe mjetet e përdorura nga Agjencia në aspektin e ligjshmërisë dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve;
- pajisjen me materiale, personel dhe teknikë të Agjencisë;
- vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet që kanë të bëjnë me një mbikëqyrje të tillë;
- çështje të tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e Agjencisë.

Agjencia në vazhdimësi, përmes masave konkrete, i realizon përpjekjet për menaxhim të suksesshëm të luftës kundër korrupsionit, i cili në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut përkufizohet si "keqpërdorim i detyrës zyrtare, autoritetit publik, detyrës ose pozitës zyrtare për përfitim, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, për vete ose për ndonjë tjetër." Në Agjenci, përveç përmirësimit të të drejtave të punonjësve, vendosen edhe standarde më të larta në punën profesionale, të cilat ndërlidhen me forcimin e kapaciteteve normative, institucionale dhe personale për t'u përballur me efektivitet me korrupsionin dhe pasojat e tij, që e

derogojnë sistemin shoqëror dhe vlerat themelore shoqërore, e rrezikojnë demokracinë dhe sundimin e së drejtës, përmes keqpërdorimit të kapaciteteve institucionale në dobi të qëllimeve të paligjshme

Në Agjenci, në pajtim me Ligjin, kryhet kontrolli i brendshëm i cili përfshin:

- vlerësimin e ligjshmërisë në punë dhe respektimin e standardeve profesionale;
- inspektimin e zbatimit të kompetencave;
- vlerësimin e shfrytëzimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit;
- inspektimin dhe vlerësimin në respektimin e rregulloreve dhe procedurave të punës;
- trajtimin e raportimeve për konflikt të interesave dhe rreziqe të korrupsionit në bashkëpunim me autoritetin kompetent;
- informimin e drejtorit për parregullsitë e konstatuara dhe dhënien e rekomandimeve për tejkalimin e tyre;
- kontrollin e menaxhimit të mjeteve materialo-teknike dhe
- dhënien e iniciativës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale dhe disiplinore.

Agjencia, duke u udhëhequr nga parimet e përcaktuara me Ligjin për Agjencinë e Zbulimit, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe bazuar në një analizë paraprake të fushave të rrezikut për korrupsion dhe konflikt interesash, ka për qëllim respektimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, barazisë, mbrojtjes dhe përgjegjësisë.

Në këtë kontekst, një nga prioritetet e Agjencisë është lufta me vendosmëri dhe jo selektive me korrupsionin dhe forcimi i integritetit dhe pavarësisë së Agjencisë në drejtim të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe Rregullores për raportim të brendshëm (dhe të jashtëm) të mbrojtur në institucionet e sektorit publik, Agjencia ka caktuar një person të autorizuar për pranimin e raporteve të denoncuesve, të cilat mund të dorëzohen në e-mail ukazuvanje@ia.gov.mk.

1. ANALIZA E ZONAVE ME RREZIK PËR KORRUPSION BRENDIA FUSHËVEPRIMIT TË PUNËS SË AGJENCISË SË ZBULIMIT

Suksesi në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave është një nga prioritetet e Agjencisë. Nga data 01.01. deri më 30.06.2021, te personi i autorizuar për pranimin e raporteve nga denoncuesit, nuk është dorëzuar asnjë aplikim (personalisht, në formë elektronike apo fizike), që i referohet raportimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm të mbrojtur, për të cilin në përputhje me obligim (neni 15 paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve) KSHPK-së i është dorëzuar raporti gjashtëmujor.

Bazuar në përvojën e deritanishme, që nga publikimi i e-mail-it ukazuvanje@ia.gov.mk (vitet 2019, 2020 dhe 2021), në mënyrë periodike pranoheshin mesazhe nga individë dhe kompani të jashtme nga vendi dhe jashtë vendit me njoftime, kërkesa ose ofrim të informacioneve, që janë jashtë fushës së denoncimit. Shumica prej tyre kanë bërë keqpërdorim të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm të adresës së shënuar, për shkak të njohjes së pamjaftueshme të

termit dhe procesit të denoncimit. Për mesazhet e pranuar janë përgatitur raporte të brendshme përkatëse.

Gjatë përditësimit të faqes së re të internetit të Agjencisë, në pjesën "transparenca" vendoset një kategori e re e dukshme "denoncim" me informacione shtesë (aktet ligjore dhe nënligjore) në lidhje me denoncimin. Kjo është bërë me qëllim të informimit dhe udhëzimit sa më të mirë të qytetarëve, të cilët dëshirojnë të kontaktojnë Agjencinë për këtë qëllim.

Përndryshe, në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, personat e emëruar në Agjenci (drejtori dhe zëvendësdrejtori) në kohë kanë dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe interesave në KSHPK, me obligim që të raportojnë çdo ndryshim në pronë.

2. ARSYET, KUSHTET DHE FAKTORËT QË MUNDËSOJNË KORRUPSIONIN

Në Agjenci si fusha të rrezikshme për shfaqje të korrupsionit janë identifikuar punësimi, prokurimet publike, dhënia e informacionit të klasifikuar, mosrespektimi i integritetit të institucionit dhe punonjësve dhe fenomene të tjera që lidhen me fushëveprimin e punës, të cilat janë në kundërshtim me rregulloret ligjore. Përkatësisht, arsyet, kushtet dhe faktorët që mundësojnë korrupsionin janë çfarëdolloj procedurash në kuadër të fushëveprimit të Agjencisë që përfshijnë çështjet e:

- konfliktit të interesave;
- lobimit;
- mashtrimeve;
- përdorimit joadekuat të kompetencave;
- tregtimit ose përdorimit të palejueshëm të informacionit;
- mosrespektimit të obligimit që punonjësit, gjatë kryerjes së detyrave të punës, të veprojnë në përputhje me rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale, të cilat zbatohen në Agjenci;
- mosrespektimit të kodit të brendshëm të sjelljes dhe veshjes së punonjësve të Agjencisë;
- shpërdorimit të pozitës dhe kompetencave zyrtare me qëllim të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të premtuar, të ofruar, të dhënë, të kërkuar ose të pritur të dobisë materiale ose jomateriale, komoditetit, avantazhit ose një interesi tjetër për vete ose për një tjetër etj.

3. MJETET DHE MEKANIZMAT E KONTROLLIT PËR TEJKALIMIN E ZONAVE TË ZBULUARA ME RREZIK

Programi i Agjencisë kundër korrupsionit synon të krijojë një sistem efektiv masash që do të mundësojnë parandalimin dhe menaxhimin e suksesshëm të korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Në këtë kuptim, për të tejkaluar sfidat që kanë të bëjnë me korrupsionin, gjegjësisht për të parandaluar dhe minimizuar shkaqet e sjelljeve

korruptive, është planifikuar të ndërmerren mjetet dhe mekanizmat e mëposhtëm të kontrollit:

- informimi i punonjësve për të drejtat dhe detyrimet e parapara me Ligjin për Agjencinë e Zbulimit, Ligjin për informacione të klasifikuara, Ligjin për qasje të lirë në informata, Ligjin për prokurime publike, Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe rregullore të tjera në fuqi, për të luftuar korrupsionin dhe konfliktin e interesave;
- respektimi i Kodit të brendshëm të sjelljes dhe veshjes së punonjësve të Agjencisë, për të siguruar:
- respektimin e ligjshmërisë, profesionalizmit dhe efikasitetit në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës;
- duke treguar se është detyrë e punonjësve në procesin e punës që të veprojnë me ndërgjegje, profesionalizëm, përgjegjësi, ndershmëri, efikasitet dhe paanshmëri;
- edukimi dhe motivimi i punonjësve gjatë procesit të punës për të njohur dhe kundërshtuar veprime të paligjshme, imorale ose të pandershme;
- ngritje në nivel më të lartë të besimit ndërpersonal përmes punës ekipore, si dhe besimit ndërinstytucional për aktivitete të përbashkëta me institucionet e tjera;
- rishikimi i kapaciteteve, masave dhe mekanizmave që ndërmerren deri më tani për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave;
- ngritja në një nivel më të lartë e standardeve tashmë të vendosura dhe vendosja e një sistemi efikas të kontrollit të brendshëm;
- identifikimi i zonave të rrezikuara nga korrupsioni;
- depolitizimi në vendimmarrje për funksionimin e Agjencisë dhe për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve;
- sanksionimi i abuzimit eventual të kompetencave;
- veprimtari në përputhje me rregulloret për prokurime publike;
- publikimi transparent i informacioneve, të cilat janë me karakter të paklasifikuar (informacione me karakter publik);
- ngritja në një nivel më të lartë e rolit të personit të autorizuar për të marrë raportime nga denoncuesit e brendshëm/e jashtëm për raportim të pavarur të sjelljeve korruptive, joetike dhe diskriminuese, nëpërmjet vendosjes së procedurave të brendshme në përputhje me rregulloret ligjore për luftën kundër korrupsionit;
- në përputhje me Ligjin për Agjencinë e Zbulimit, rritje e transparencës gjatë punësimit me shpallje publike (apo marrjen nga një institucion tjetër), si dhe gjatë prokurimeve publike;
- mundësimi i funksionimit normal të revizionit të brendshëm dhe zbatimi i plotë i menaxhimit dhe kontrollit financiar;
- forcimi i rolit të kontrollit të brendshëm, si dhe i sektorit të resurseve njerëzore

4. FORCIMI I KAPACITETEVE TË AGJENCISË ME THEKS TË VEÇANTË NË FORCIMIN E INTEGRITETIT TË PUNONJËSVE

Në periudhën në vijim, Agjencia do të punojë në vazhdimësi në forcimin e integritetit të punonjësve dhe rritjen e efikasitetit të procedurave për përmirësimin e politikës së integritetit.

Punonjësit e Agjencisë janë të detyruar të respektojnë dhe zbatojnë rregulloret ligjore, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme, në mënyrë të ndërgjegjshme, të përgjegjshme, profesionale dhe të paanshme. Kjo do të thotë se ata kanë detyrim të veprojnë në mënyrë etike, pavarësisht nëse janë në detyrë apo jo. Domethënë, vetëm veprimi profesional, ligjor dhe etik do të forcojë integritetin e punonjësve dhe në këtë mënyrë do të kontribuojë në eliminimin e mundësisë së shfaqjes së korrupsionit. Në të njëjtën kohë, Agjencia do të përpiqet t'u sigurojë mbështetje punonjësve në kryerjen e detyrave profesionale përmes menaxhmentit, i cili do të promovojë forcimin e integritetit. Një segment i rëndësishëm do të jetë zbatimi i politikave të menaxhimit të resurseve njerëzore, të cilat do të synojnë përmirësimin e aftësive të punonjësve dhe do të sigurojnë një mjedis pune cilësor. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe nivelit të lartë të pritur të integritetit të Agjencisë gjatë zbatimit të politikave dhe procedurave për resurset njerëzore, që do të motivojnë, mbështesin dhe mundësojnë zhvillimin dhe përmirësimin.

5. VEPRIMI NË KOHË

Me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, Agjencia, e cila vepron në një rajon jashtëzakonisht kompleks, fitoi qasje dhe shkëmbim më të shpejtë të informacionit, por edhe me veprim dhe drejtim kolektiv në aspektin e prioritetëve, sfidave dhe kërcënimeve të përbashkëta.

Në këtë drejtim, Agjencia funksionon sipas standardeve, kritereve dhe procedurave më të larta të NATO-s, i respekton plotësisht procedurat e punës, i përpunon në kohë dhe me shpejtësi materialet e klasifikuara (dhe të paklasifikuara) tek përdoruesit përfundimtarë (kryetari i RMV-së, kryeministri i RMV-së, kryetari i Kuvendit i RMV-së, Këshilli koordinues i bashkësisë së sigurisë-zbulimit, si dhe organet e tjera të administratës shtetërore në varësi të çështjeve që janë objekt i raportimit).

Një segment i rëndësishëm në punën e Agjencisë, i cili synon të forcojë besimin në shoqëri dhe të njihet integriteti, përgjegjësia, profesionalizmi, autonomia dhe objektiviteti i shërbimit si një partner profesionist, i besuar dhe i përgjegjshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është mbajtja e një komunikimi të vazhdueshëm si me organet shtetërore, veçanërisht nga bashkësia e sigurisë-zbulimit të RMV-së, ashtu dhe me autoritetet e huaja të sigurisë.

6. RESPEKTIMI I RREGULLOREVE LIGJORE

Angazhimet e Agjencisë, në përputhje me kompetencat që dalin nga Ligji për Agjencinë e Zbulimit, janë harmonizimi i dispozitave dhe praktikave pozitive për luftën dhe çrrënjosjen e korrupsionit në aktet nënligjore dhe procedurat e brendshme. Në këtë kuptim, në fushëveprimin e Agjencisë merret parasysh legjislacionin pozitiv, si në vijim:

- Ligji për punonjësit e sektorit publik (kapitujt III dhe IV);
- Ligji për prokurime publike;
- Ligji për informacionin e klasifikuar;
- Ligji për qasje të lirë në informacione;
- Ligji për mbrojtjen e denoncuesve;
- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ligji për qasje në informacione me karakter publik.

Me qëllim që punonjësit e Agjencisë të manifestojnë një shkallë të lartë integriteti dhe të jenë në gjendje t'i njohin të gjitha format e korrupsionit dhe sjelljeve korruptive, aktivitetet e Agjencisë synojnë:

- monitorimin e vazhdueshëm të kornizës normative, iniciativave dhe projekteve, si në nivel kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe zbatimin e tyre në Agjenci;
- përfshirjen e Agjencisë në iniciativat e luftës kundër korrupsionit dhe përshtatjen e tyre me kompetencat e Agjencisë;
- informimin e rregullt të punonjësve për detyrimin gjatë kryerjes së detyrave të punës, që të veprojnë në përputhje me rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale, të cilat zbatohen në Agjenci dhe se askush nuk bën përjashtim në caktimin e përgjegjësisë për sjellje korruptive;
- respektimin e Kodit të brendshëm të sjelljes dhe veshjes së punonjësve të Agjencisë së Zbulimit.

7. FORCIMI I BESIMIT TË QYTETARËVE TEK AGJENCIA DHE MOTIVIMI I TYRE PËR TË RAPORTUAR KORRUPSIONIN

Në bazë të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe dispozitave të Rregullores për raportim të brendshëm/të jashtëm në ueb faqen e Agjencisë në rubrikën Transparenca, është krijuar nën-rubrika Denoncues, ku është funksionale adresa e-mail ukazuvanje@ia.gov.mk, që ka për qëllim të forcojë pozitën e denoncuesit, i cili, me qëllim të mirë, bën raportim të mbrojtur të brendshëm ose të jashtëm të parregullsive dhe dyshimeve për mashtrim dhe korrupsion në AZ dhe te personi i autorizuar për pranimin e raporteve nga denoncuesit.

Në të njëjtën kohë, Agjencia ka caktuar një person për komunikim të drejtpërdrejtë me KSHPK-në, përgjegjës për integritetin e punonjësve dhe institucionit.

8. KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E PËRFORCUAR E PROKURIMEVE PUBLIKE

Përpjekjet e Agjencisë gjatë zbatimit të prokurimeve publike dhe zbatimit të kontratave të prokurimeve publike, të cilat konstatohen si më të ndjeshmet ndaj korrupsionit, duke ndërmarrë masat e duhura për zbulimin, parandalimin dhe çrrënjosjen e veprimeve korruptive. Në këtë drejtim, AR ndërmerr aktivitetet e mëposhtme:

- respektimi i procedurave për zbatimin e veprimeve të prokurimeve publike dhe realizimin e kontratave të shënuara në Ligjin për prokurime publike;
- kontrolli mbi zbatimin dhe respektimin e procedurave për zbatimin e veprimeve të prokurimeve publike, si dhe realizimin e kontratave;
- edukimi i punonjësve të përfshirë në procedurat e prokurimeve publike, për t'i respektuar parimet bazë (trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomik dhe mosdiskriminimi, pra ndalimi i favorizimit të subjekteve të caktuara, si dhe transparenca, e cila siguron konkurrencë dhe integritet në prokurime publike)

9. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL DHE BASHKËPUNIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT

Një segment i rëndësishëm në punën e Agjencisë, i cili synon të forcojë besimin në shoqëri dhe të njihet integriteti, përgjegjësia, profesionalizmi, autonomia dhe objektiviteti i shërbimit si një partner profesionist, i besuar dhe i përgjegjshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është mbajtja e një komunikimi të vazhdueshëm me autoritetet shtetërore, veçanërisht nga bashkësia e sigurisë-zbulimit të RMV-së, si dhe me autoritetet e huaja të sigurisë. Duke pasur parasysh se bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe shkëmbimi në kohë i informacionit janë kyçe në luftimin e korrupsionit, Agjencia do të vazhdojë të punojë për ta përmirësuar bashkëpunimin e vendosur, që do të kontribuojë në zbulimin dhe sanksionimin në kohë të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në këtë kontekst, Agjencia bashkëpunon me institucionet e tjera nga bashkësia e sigurisë-zbulimit të RMV-së, organet e administratës shtetërore, institucionet publike dhe subjektet e tjera juridike për çështje të interesit të përbashkët, si dhe bashkëpunim ndërkombëtar me shërbimet e zbulimit dhe sigurisë nga vendet e tjera, duke u përfshirë kështu drejtpërdrejt në luftën për çrrënjosjen e korrupsionit.

Në këtë plan, Agjencia do të veprojë për të rritur bashkëpunimin me të gjitha institucionet përkatëse shtetërore dhe do të marrë pjesë në iniciativat në luftën kundër korrupsionit.

10. LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA NË FUNKSIONIMIN E AGJENCISË

Agjencia, informacionet nga fushëveprimi i punës, të cilat janë me karakter publik, i ka publikuar në mënyrë transparente në faqen e internetit, ku në rubrikën TRANSPARENCA, përveç nën-rubrikave “mbikëqyrja dhe kontrolli” dhe “denoncues” janë krijuar dhe nën-rubrikat:

- Dita e AZ-së - në kuadër të përpjekjeve për transparencë më të madhe, hapje dhe kontakt të drejtpërdrejtë, u krijua projekti "Dita e AZ-së" (Vizitë studimore

në AZ të nxënësve dhe studentëve nga fusha e studimeve të sigurisë, të cilët njihen me fushën e veprimtarisë, funksionimin, kompetencat ligjore dhe rolin e AZ-së, si institucion i bashkësisë së sigurisë-zbulimit të vendit;

- Kontakti me mediat - për shkak të rritjes së nivelit të informimit të qytetarëve për punën dhe kompetencën e AZ-së dhe ndërtimin e një qëndrimi të hapur, transparent dhe profesional ndaj mediave është në funksion e-mail adresa press@ia.gov.mk;
- dokumente publike, ku publikohet llogaria përfundimtare.
- njëkohësisht, prokurimet publike, në pajtim me Ligjin për prokurime publike, publikohen në SEPP, kurse Buxheti dhe rebalanci i Buxhetit të Agjencisë, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.